



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-32726 dt. 07.07. 2023

EKSTRAT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **29.06.2023** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Sali Dvorani (DD) Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD), Mirlinda Dvorani (PDK). **Mungoi Muhamet Kurtaj.**

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtor të Drejtorive komunale, zyra e informimit, Përfaqësues të Institutit INSI** për prezantimin e Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc. Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 26.05.2023 dhe vazhdimi i mbledhjes me dt. 31.05.2023
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor.
3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllogoc.
4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.
5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
7. Vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Zveçanit.
8. Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.
9. Të ndryshme

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 29.06.2023, ku për diskutim ishin 9 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari.

Labinot Halilaj, propozim vendimi për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake a ka qenë ky propozim i seancës kaluar, në kuadër të votimit që e kemi pas në seancën e kaluar është propozimi i njëjtë.

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, ky propozim vendim është votu në seancën e kaluar por gjatë periudhës kohore prej mbledhjes së kaluar është aprovuar ligji për bartjen e të hyrave nga vitet e kaluara, në propozimin e kaluar e keni pas nenin 6 mirëpo me aprovimin e ligjit ku lejohet edhe bartja e mjeteve të viteve paraprake u dashtë me e bërë ndryshimin ku thotë: Paragrafi 6, i nenit 9 të Ligjit Bazik, riformulohet me tekstin si në vijim: 6. Bilancet e pashpenzuara të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2022 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të LMFPP-së, duke ruajtur strukturën e shpenzimeve dhe aprovuar me vendim të Kuvendit të Komunës. Në propozimin e parë në kategorinë e Shpenzime Komunale kemi pas një shumë prej 24,000.00 € të cilat në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Emergjencës ku na ka kërkuar për arsye të ngritjes së çmimit të rrymës dhe rritjes së rritjes të ndriçimit publik është dashtë të plotësohet ajo shumë për me mujt me i mbulua shpenzimet e ndriçimit gjegjësisht të energjisë, mirëpo për me ruajt strukturën u dashtë nga niveli qendror u kërku që struktura e shpenzimit të ruhet, është dashtë të rritet edhe shuma për subvencione që nuk janë shpenzime operative, ky është ndryshimi i vetëm me propozim vendimin e kaluar.

Beqir Kiqina, sa i përket pikave të rendit të ditës, unë ndalem tek procesverbali, e shoh që procesverbalit i mungon shumë nga ajo se çka është thënë mbledhjen e kaluar sidomos në mbledhjen e parë të dt. 26.05.2023, fq. 6 dhe 15 i shoh se si i kanë cungu fjalimet sidomos fjalimin tim dhe nuk i kanë hedh fare replikat, replikat e dikuj i kanë hedh çka ka thënë, kisha dashtë që herëve të tjera, edhe pse e kuptoj se kjo nuk është transkript është procesverbal por kërkoj që herëve të tjera me qenë më të përgjegjshëm, pasi që janë të inçizuara mbledhjet me i shkru me i degju dhe kanë kohë një muaj apo një muaj e gjysmë me punu një procesverbal të paktën 70-80% me paraqit të asaj çka është thënë, mos të mujshin % sepse ky nuk është ajo çka kam thënë, janë dy tri fjalë, kam fol shumë më shumë.

Egzona Tërdevci, unë ka kohë që jam duke e përsërit një kërkesë që njëra prej pikave të rendit të ditës me qenë diskutim pyetje përgjigje me Drejtoret e Drejtorive Komunale për shkak se kur po na mbesin çështjet me i diskutu tek të ndryshmet shumica nga ata nuk po kanë mundësi me nejt, nuk po them nuk po rrinë, por i arsyetoj se e di që kanë edhe punë të tjera, edhe ju dhe z. Lladrovci nuk keni pas ndonjë kundërshtim që me u shtu kjo si pikë e rendit të ditës në seanca, dhe po shpresoj se herën tjetër keni me pas parasysh dhe me shtu si pikë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, znj. Tërdevci nëse e ki fjalën me kalu nga të ndryshme tek pika e parë sikur është procedurë në parlamentin e Kosovës na e bëjmë nuk e kemi atë problem, pra asnjëherë nuk kam mungu në mbledhje qoftë edhe tek pika të

ndryshme, kam mungu mbledhjen e kaluar, ndërsa përgjigjen për herën e kaluar për guximin ta japi gjatë pikave për ku je thirr.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, (Për) votuan 26 anëtar, kundër nuk pati, abstenim 4 vota, u miratua rendi i ditës pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 26.05.2023 dhe vazhdimi i mbledhjes me dt. 31.05.2023.**

Ezgon Tërdevci, procesverbali vazhdimisht shkruhet keq, nuk është që shkruhet në rregull me gjuhën shqipe dhe unë personalisht dhe koleget e mi nuk mundemi me votu një procesverbal të tillë sepse pas disa vitesh mundet dikush me i lexu dhe askush prej neve nuk kemi fol në atë formë.

Pas këtyre diskutimeve kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, (Për) votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, abstenim 6 vota, u miratua rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor.**

Shyqiri Bublaku-Drejtor i Financave, sa i përket buxhetit 2024 dhe parashikimit të viteve 2025-2026 në bazë të qarkores se parë buxhetore të dërguar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kemi marrë njoftimin se kufijtë e buxhetit të komunës së Drenasit për vitin 2024 do të jenë më të lartë në tre sektorë: Sektori i Administratës nga 9,126,783 € ka shku në 10,234,624 €, Sektori i Arsimit nga 6,564,735 në 7,870,632, Sektori i Shëndetësisë 2,465,374 në 2,863,736, pra shuma e përgjithshme për vitin 2024 e Komunës së Drenasit do të jetë: **20,968,992 €**, kjo kish me qenë sa i përket buxhetit të sipas sektorëve, ndërsa nëse e shohim buxhetin sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 pagat në vitin 2024 do të rriten për shkak të ligjit të buxhetit i cili ka ndryshu dhe ka shku **11,043,631 €**, buxheti për mallra dhe shërbime edhe ky është rrit për shkak të ndryshimit të strukturës të shpenzimeve në **2,711,434 €**, shërbimet komunale janë rrit janë bërë **348,449 €**, subvencione **493,000 €**, shpenzime kapitale **6,372,478 €** shuma e përgjithshme e buxhetit do të jetë **23,140,465€ për vitin 2024-2026**.

Egzona Tërdevci, e para e dimë që procesi i kornizës afatmesme buxhetore fillon me dëgjime publike sa kam parë nga faqja e komunës dhe nga procesverbalet është mbajtur vetëm një dëgjim publik, vitin e kaluar është mbajtur edhe nëpër fshatra, kur është ideja me i mbajtur ato dëgjime publike, pastaj po filloj me disa pyetje që i kam lidhur me projektet kapitale që janë parashiku, po e nisi me shqetësimin ma te madh të qytetareve të Drenasit mungesën e ujit të pijes për vitin 2024 janë planifikuar vetëm 200,000.00 € për ndërtim të kapacitetit të ujësjellësit në Drenas duke e dit që është i ndërlidhur me nivelin qendror, a mendoni që këto janë të mjaftueshme për furnizim me ujë të pijes për qytetaret e Drenasit, është pastaj një projekt tjetër ndërtimi i shtëpisë për komunitete, shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuar, ne para disa seancave e kemi ngrit shqetësimin e shoqatës të shurdhërve në Drenas, nëse mundeni me tregu cilat kategori të personave me aftësi të kufizuar kanë me qenë përfitues të ndërtimit të kësaj shtëpie të komunitetit, që ne si grup e vlerësojmë ndërtimin e një shtëpie të tillë, është projekti i digjitalizimit të shkollave me softuer dhe pajisje tjera përcjellëse një projekt i tillë ka qenë

edhe në vitin 2023 ka qenë në vlerë prej 80,000.00 € pse nuk është realizuar në vitin 2023 apo është fjala për vazhdim të këtij projekti. Ndërtimi i shkollës së re "Rasim Kiqina" në Drenas 25,000.00 € nuk e di nëse është ideja me nis si projekt apo sa munden me mjaftu 25,000.00 € për me nis një shkollë. Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci" "Drenas" në kuadër të tenderit të sheshit planifikohet edhe një lloj muzeu, çfarë muzeu është sepse e kemi kërkesën që të fillohet një muze i luftës, nuk është kërkesë e jona personale është kërkesë që na u është përcjell nga familja Muqolli kur kemi qenë në përvjetorin e tyre, nuk po besoj se kjo duhet me pas ane politike se është diçka që na bashkon të gjithëve. Po ashtu i kam disa shqetësime lidhur me fshatin Gllobar kam parë që në disa fshatra janë rregulluar vend ndaljet për stacion të autobusëve por jo edhe në Gllobar një projekt i tillë nuk parashihet as për vitin 2024, kur mund të behët kjo? Po ashtu është shqetësimi që e kemi ngrit edhe vitin e kaluar çështja e projekteve të përmbledhura, ta zëmë ka asfalt për Gllobar por nuk mund ta dimë nëse nuk janë të specifikume ku do të shtrohet ose cilat rrugë do të asfaltohen, ne e kuptojmë çështjen e planit të prokurimit por e kemi ngrit edhe vitin e kaluar kur është diskutu korniza afatmesme buxhetore por edhe kur është diskutua buxheti që do të mund të na përgatitni një plan të brendshëm se sa do të shtrohet asfalt, sa do të shtrohet kanalizim secilin fshat se në këtë formë edhe ne e kemi problem me ditë por edhe e kemi problem me iu përgjigj qytetareve për kërkesat që i kanë për fshatrat e tyre.

Labinot Halilaj, edhe unë kisha pas për diskutim sidomos tek pjesa e projekteve kapitale që kapin vlerat ma të mëdha-ja, gjithmonë po lidhem me periudhën **2024-2026**, thotë asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë **900,000.00 €**, Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Drenas-Dobroshec **1,000,000.00 €**, për gjithë periudhën po flasim, Rregullimi trotuareve dhe ndriçimi publik Drenas, Komoran, Arllat, Terstenik, Dobroshec dhe Baicë **1,010,000.00 €**, Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci" Drenas **1,100,000.00 €**, Ndërtimi, zgjerimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas **1,963,455.00 €**, Ndërtimi, zgjerimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Drenas **1,139,000.00 €**, a ka të bëjë me planin rregullativ të qytetit që e determinon, Hapja dhe ndërtimi i rrugëve fushore **1,221,425.00 €**, shihet që nëpër fshatra ka një ramje pak ma të madhe të investimeve kapitale dhe vlerat janë të koncentruar ma shumë tek 5-6 projekte, a është kjo zgjidhja ma e mirë që është propozu rreth projekteve kapitale a ka edhe ndonjë diçka që është ma e domosdoshme me i orjentu mjetet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Egzona edhe në Komitet për Politikë dhe Financa e kemi ngrit problemin e mjeteve të alokume për ujë të pijes, komuna i ka kry krejt shërbimet e veta janë të mjaftueshme 200,000.00 € euro për procedurat që kanë mbet janë të mjaftueshme për këtë vit, pastaj është përgjegjësi e kompanisë të cilën do ta keni në mbledhjen e ardhshme këtu për të diskutuar me të pse nuk ka ujë dhe pse po i penalizon qytetarët një pjesë të Komoranit dhe një pjesë të fshatrave anej, pse po i penalizon që nuk po ia lëshon ujë për shkak se ata nuk i kanë vendos orët ujëmatëse, është çështje e tyre. Ndërtimi i shtëpisë për komunitete- shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara është projekt i qeverisë. Projekti i digjitalizimit të shkollave me softuer dhe pajisje tjera përcjellëse në proces jemi edhe këtë vit edhe vitin e ardhshëm nuk mujm me nda përniher por nuk mundemi. Projekti i shkollës "Rasim Kiqina" i kemi pas dy ide po mandej ma kanë sqaru se është shtesë apo aneksi i shkollës, ne e kemi pas ide me e dergu në Shtrubulovë, me e fut si kod për me mujt me marrë donacione ose grande nga niveli qendror për një shkollë në Shtrubulovë. Muzeu i Luftës ia kam sqaru disa herë, muzeu do të bartet në shesh dhe e keni pa edhe në projekt, dmth. kjo pjesa që është këtu do të hiqet dhe do të bartet atje edhe pa dyshim se do të jetë edhe familja Muqolli që kemi shumë respekt dhe ka humb shumë nga djemtë, vajzat, pleqtë dhe gratë e tyre. Në fshatin Gllobar pse nuk ka stacion të autobusëve, nëse e ki fjalën për

rrugën regionale Drenas-Skenderaj e pa përgjegjësi niveli qendror, e ka kry ne disa pjese besoj se do ta përfundoj edhe atë, nuk është pjesë e jona, rend i ka bërë niveli qendror. Çështja e projekteve të përmbledhura ne e kemi sqaru disa mandate se jemi duke i mbledh edhe projektet sigurisht edhe gjatë dëgjimeve publike e din që kërkojnë dhe ato do të vendosim se sa metra ose km nëpër lagje do te ndërtohen. Lab projektet kapitale asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë është projekt i joni i cili është premtim i imi dhe e ka meritë ajo zonë edhe ia shton vlerën asaj zone që është një zone shumë strategjike dhe shumë e mirë. Sa i përket trotuareve, Ndriçimit është një kod të cilat po i bëjmë në Baicë ato pjesë që nuk kanë me mujt me përfundu sivjet kane me u kry ne vitin tjetër dhe janë mjete të cilat janë paraparë. Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci" Drenas zotimi i mjeteve për 2025-2026 e kemi obligim me i votu dhe u votu, e kemi obligim me i shti mjetet sepse janë të miratuara, dmth i keni miratu ju me votën tuaj. Rikonstruimi i rrjetit te kanalizimeve aty ku nuk e kemi kry ende jemi në proces aty ku ka dame jemi duke e kry, nuk lidhet me planin rregullues sepse ato vetëm ekzistojnë, hapja e ndërtimit të rrugëve fushore e ceke edhe vet se nuk ka mbet lagje po thuajse pa u asfaltua, ne një ditë kemi me i kry edhe rrugët publike dhe fushore me i kry.

Egzona Tërdevci, nuk mora përgjigje për dëgjimet publike nëse kanë me vazhdu ose jo për KAB apo mbeten deri në shtator. Për projektin i cili është nga niveli qendror për ndërtimi i shtëpisë për komunitete të paktën paraprakisht ju informojnë apo koordinoheni me juve për këtë projekt. Kam një pyetje specifike për z. Gllareva unë kam bërë kërkesë si përfaqësuese e lagjes qysh në vitin 2022 për shtrimin e një rruge dhe kam bërë kërkesë për me emertu rrugën "Xheladin Tërdevci" pjesa e rrugës të lagjes time, qysh në vitin 2022 me keni thënë se kryhet brenda vitit 2022, nuk ka fillu asgjë për atë pjesë, nuk e di nëse planifikohet për 2023 ose të paktën me ditë nëse është për 2024 meqë projektet janë të grumbulluara dhe nuk ka mundësi me dit ndryshe.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne jemi në dëgjim të parë sigurisht pas miratimit të kësaj pike ne e kemi procedurë me dal në dëgjime publike nëpër fshatra sigurisht ne ato fshatra sikurse që i kemi paraparë edhe viteve tjera. Ndërsa për rrugë u lidh kontrata do të shtohet, ndërsa sa i përket emërimit të rrugëve është përgjegjësi e juaja nuk është përgjegjësi e jona.

Pas këtyre diskutimeve vërejtjeve, sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, (Për) votuan 26 anëtar, 4 vota kundër, abstenim nuk pati, u miratua **Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026, lista e projekteve kapitale 2024-2026 dhe buxheti i përgjeshëm gjinor.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sot në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës pikë e rendit të ditës është edhe **planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc për vitin 2023-2031** si dokument i planifikimit hapësinor që përcakton kushtet për rregullimin e hapësirave për zonën urbane. Komuna jonë me miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit gjatë qeverisjes time e kompletton legjislacioni në fushën e planifikimit hapësinor me hartën zonale të komunës dhe planit zhvillimor komunal tani më në fuqi. Me **miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc** fillon faza e re e zhvillimit për qytetin për të gjitha ndërtimet e ulta, të mesme dhe të larta në Drenas,

hapja e shqyrtimit publik është mbajtur me 9 mars 2023 në ora 11:00 në sallën e këtij kuvendi në të cilën kemi pas mundësi të merrni pjesë në prezantimin e këtij dokumenti dhe të jepni komentet, sugjerimet dhe vërejtjet ehe me shkrim në afat prej 30 ditësh, duke pas parasysh rëndësinë e këtij dokumenti të planifikimit hapësinor ne kemi sot prezent kompaninë që ka hartu planin rregullues të hollësishëm për elaborim para se të vendoset në miratim. Shpreh falënderim për ekspertet e kompanisë hartuese të planit rregullues të hollësishëm nga INSI-shpk, ekipit komunal për planifikim hapësinor si dhe gjithë qytetaret me grupet e interesit që morën pjesë në harimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për zhvillimin e hollësishëm të qytetit tonë. E ftoj kompaninë me zberthy dhe me u përgjigj në interesimin e asamblistëve.

Instituti INSI-Përfaqesues të harimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Gllgoc-

Prezantuan: edhe pse projekt plani rregullues i hollësishëm për zonën qendrën e qytetit në Gllgoc, me fillim kemi bërë diskutimet dhe kemi punuar me grupin punues, kemi bërë shqyrtimet publike e të gjitha kemi pas kërkesë që me bërë një prezantim të shkurtë sa i përket punë që është bërë me planin rregullues, ne fillimisht kërkesat themelore për hartimin e planit rregullues na jep reforma ligjore na obligon që ne me u bazu në dokumentet e planifikimit hapësinor siq është plani zhvillimor komunal, harta zonale, planet rregulluese të mëhershme që ka pas, gjithashtu parasheh edhe pjesëmarrjen publike gjatë të hartimit të dokumentit, digjitalizimin e të dhënave të planifikimit hapësinor, normat teknike të planifikimit hapësinor direktivat siç janë inspair përdorimi i tokës, hsrll, e gjitha këto. Planin rregullues ka një pjesë tekstuale dhe pjesën hartografike, ku pjesa tekstuale ka një përmbajtje të veten në bazë të udhëzimeve ashtu siç na kërkon dhe gjithashtu ka pjesën hartografike ku përmban gjitha shfrytëzimet e saj duke u bazu në kërkesat ligjore që i ka. Qëllimi është përgatitja e planit rregullues të hollësishëm si një shembull për të ardhmen të cilën do të krijoj bazat e qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, pra tek kjo fillimisht ndërlidhja e planit rregullues na obligon që duke filluar prej sistemit hierarkik që është nga qeverisja që ka planin hapësinor i Kosovës fillon tek plani zhvillimor komunal, harta zonale në nivel të komunës dhe planet rregulluese të mëhershme, tek pjesa e parë kërkohet me u be një vlerësim një analizë e gjendjes ekzistuese ashtu siç është zona për të cilën behet fjalë, me pas parasheh tri skenarë për zonën që parashihet analiza e këtyre tri skenarëve dhe behet planifikimi i zonës për të cilën diskutohet. Skenari i parë ka rrjedh si derivat i gjendjes ekzistuese ashtu siç është një here për një here zona, skenari i dytë rrjedh nga harta zonale që ligji na obligon neve me u bazu në hartën zonale dhe skenari i tretë si skenari përfundimtar rrjedh nga kombinimi i këtyre dy skenarëve dhe ipen kushtet për zhvillimin e zonës.

Pjesa tekstuale parasheh të gjitha duke filluar prej infrastrukturës teknike, ka infrastrukturën publike, trashëgiminë kulturore natyrore.

Pjesa hartografike ka të gjitha hartën e blloqeve urbane, hartën e kategorizimit të rrugëve hartën e profilit të rrugëve, harta e planit të nivelimit, harta e destinimit të sipërfaqeve harta e përmbajtjeve atraktive që ka brenda zonës, harta e vijës rregulluese dhe ndërtimore, harta e etazhitetit, harta e planit të parcelimit, harta e kushtit të rregullimit, harta e rrjetit elektro-energjetik, harta e rrjetit të ujësjellësit, harta e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, harta e kanalizimit të rrjetit atmosferik dhe harta e rrjetit të ngrohjes. Pra pjesa hartografike hartohet sipas kërkesave dhe specifikave teknikave të vendosura në udhëzim administrativ mbi bazën e të dhënave hapësinore. Me kaq e përfundoj këtë.

Egzona Tërdevci, sa me kujtohet nga drejtoresha është përzgjedh skenari tretë për planin zhvillimor të qytetit, pyeti rreth infrastrukturës dhe transportit e keni paraparë stacionin

multi-medal po e shoh që është lokacion i ri nëse mundeni me na spjegu për cilin lokacion behet fjalë dhe nuk po e shoh kerkun stacioni për tramvaj i cili është premtim i kryetarit a ka me u be kjo a jo?

Instituti INSI-Përfaqesues të harimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- fillimisht ky është një plan rregullues i hollësishëm i cili ka për qëllim ku tregon kushtet se si ka me u zhvillu një nenzonë, me herët i kemi quajti nenbllloqe, tani është me ligjin e ri me udhëzimin administrativ quhen si nenzona dhe brenda atyre zonave ipen kushtet se si ka me u zhvillua të ardhmen se si ka me u leshu një leje ndërtimore për një zhvillim të caktuar, sa i përket pyetjes tuaj stacioni i autobusëve- stacioni i trenit stacion multimodal është i aplikuar shumë vende të botës por edhe te rajonit si në Kroaci, Slloveni ku i ke stacionin e trenit të autobusëve, parkingun për çiklist, taksist dmth janë gjitha me një vend në të njëjtën mundesh me shfrytezu të njëjtën bilet për me lëviz nëpër zona të ndryshme të qytetit. Stacioni multimodal është tek stacioni i trenit por ju keni pas mundësi 30 ditë e keni pas shqyrtim publik dhe keni mujt me i pa edhe kushtet që janë dhënë dhe keni mujt me i bë edhe me shkrim dhe kishi marrë edhe përgjigjet.

Labinot Halilaj, ne kemi prit që prezantimi me pas edhe më shumë detaje jo vetëm në vija të trasha dhe në prezantim ndoshta ish dashtë me prezantua INSI- çfarë kompanie është sa eksperiencë ka, se nëse flasim për planin rregullativ të qendrës së qytetit është nder temat më kryesore për qytetin tonë, nëse ai plan rregullativ është i mirë ka me na përcjell neve nder vite, dhe nëse e kemi një plan jo të mirë të qendrës se qytetit atëherë ne kemi me e shemtu planin rregullativ të qendrës se qytetit, dhe sa është premtues ky plan i qendrës se qytetit a i ka mbërri të gjitha objektivat?

Instituti INSI-Përfaqësues të hartimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- ne nuk parapëlqejmë me fol për veten por ne punojmë gjithë Kosovën, me plane zhvillimore komunale, me harta zonale dmth nuk ka komunë që nuk kemi punu dhe është 22-23 plani rregullues që e kemi punu për Kosovë por edhe me organizata të ndryshme ndërkombëtare. Jemi institut nuk jemi kompani. Premtues është për shkak se plani është i bazuar në planin zhvillimor komunal, në hartën zonale kushtet të cilat janë caktu për zonën në hartën zonale, po ashtu është analizua edhe gjendja ekzistuese, janë marrë parasysh edhe grupet e interesit brenda zonës, qytetaret që i kanë paraqit pyetjet e tyre i kanë marrë përgjigjet e tyre dhe gjitha këto janë harmonizua dhe mendojmë se plani i ka mbërri gjitha objektivat e veta ne komfor legjislacionit komfor standardeve që kërkohen dhe normave teknike të planifikimit hapësinor, kjo është ajo dmth çka na e përcjellim dhe kjo e jep formën e vet profesionale sepse bazohet ne legjislacionin ekzistues, gjendjen ekzistuese ne interesat e zonës se qytetareve dhe në planet të cilat kanë qenë ekzistuese të cilat kanë kriju një efekt në zonë.

Labinot Halilaj, po flasim për planin rregullativ të qendrës se qytetit, i keni ndjek gjitha ato procedura, më shumë po flisni në aspektin ligjor, më saktësisht çka është bërë në këtë plan rregullativ që ka me ndiku ma mirë për qendrën e qytetit të Drenasit. Çka presim prej gjitha këtyre ne vija të trasha kërkoj sqarim.

Instituti INSI-Përfaqësues të hartimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- ne i kemi disa ekiye mbështetëse për komunikacion e kemi epiken që merret vetëm me çështjen te komunikacionit, ne e kemi prezantua planin para qytetareve, plani rregullues i hollësishëm ky plan në këtë rast i jep kushte zhvillimore për secilën nenzonë, jep kushte për etazhitetin kur i përmendi ma herët parafolësi kur i prezantoi, jep kushte për distanca objekti prej objekti, jep kushte për rrugët të cilat kanë qenë edhe rruge

ekzistuese por edhe të planifikuara me planet e mëhershme, pra ky plan i detajizon pra tregon deri ku ka me qenë vija ndërtimore sa ka me kanë e gjanë, sa ka me qenë trotuari i gjanë, dmth i jep qito kushte që ka me ia lehtësu jetën juve, ka me ia mundësi me pas qasje ma te mire në rrugë, nëse aplikon për leje e din saktësisht se në atë zonë çfarë zhvillimi ka me u bë, çfarë etazhiteti çfarë largësie objekti prej objekti, çfarë lloji i objektit ka me u ndertu, çfarë lloji i shfrytëzimit ka me qenë, deri tek detajet me të imta edhe niveli i zhurmës dhe bezdisjet te tjera në zonë dmth kemi me i pas gjitha këto detaje që na lehtëson jetën, plus kësaj u bë edhe një vlerësim strategjik mjedisor të cilën është prezentu, po ashtu ka pas edhe proces dhe janë vlersu gjitha aspektet për lehtësimin e jetës se qytetareve dhe me ia mundësi një qasje me te mirë në rrugë në infrastrukturë në çështjet tjera të cilat i parasheh plani në zonë.

Arbër Halilaj, meqë ka qenë temë që është debatuar shumë zgjerimi i sheshit “Fehmi e Xhev Lladrovci” që hyn tek parqet publike dhe hapësirat e hapura publike në faqen 139 pika pika **7.1.1.3. Vlerësimi i nevojës për institucione shitesë bazuar në numrin e planifikuar të banorëve** kerkoj një sqarim profesional të këtij që po e parafrazoj: Bazuar në analizën e kërkesës minimale të Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për madhësinë e parcelave kadastrale prej 1.00 m2/banor dhe shtrirjen e infrastrukturës ekzistuese, rezulton që në lagjen urbane “Qendra e Qytetit” nuk ka nevojë për destinimin e sipërfaqeve shitesë të parcelave kadastrale për hapësira të gjelbra publike, madje tejkalon atë për +4,087m2. Kerkoj një sqarim për këtë si e definoni ju?

Instituti INSI-Përfaqësues të hartimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- gjitha detajet nuk mundemi me i dit se kemi edhe grupe tjera që kane punu, por po, mundohna në vija të trasha me sqaru, janë norma teknik e të cilat të cilat janë me udhëzimin administrativ dhe ato neve na detyrojnë me e bërë kalkulimin në bazë të numrit të banoreve me e pa në zonë sa ka gjelbërim, dhe sa nevojiten për m2 për kok banori, i keni të caktuara dhe te detajuzuara në kuadër të dokumentit.

Hamit Kastrati, a do të ketë hapësirë të mjaftueshme për stacion te autobusëve aty ku do të zhvendoset stacioni i autobusëve dhe si do të duket stacioni i autobusëve për momentin ?

Instituti INSI-Përfaqësues të hartimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- e ceka edhe me lartë ata që merren me çështjen e komunikacionit janë ekspert te fushës të komunikacionit por unë po mundohem, ata e kanë analizua vet dhe e kanë shiku se ka mundësi me u bë një zhvillim i tillë dhe i kanë pas parasysh gjitha standardet dhe besoj se ka me funksionua, se si ka me u duk ajo është projekt mandej ky është plan , e plani prej plani derivon projektet që janë me detaje, ka me pas projekt për zonën ku e detajizon se si doket, por ne këtë rast i ka vetëm kushtet zhvillimore se si ka mundësi në të ardhmen me u zhvillu një stacion multimodal.

Mehedin Salihu, e kam fjalën për nënkalime, a do të ketë dhe sa do të jete numri i tyre?

Instituti INSI-Përfaqësues të hartimit të planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc- po janë të parapamë disa saktë nuk mund ta di se janë në plan, aty ku ka qenë e nevojshme janë të paraqitura.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, në plan janë të parapamë rruga katër korsi me hy nen hekurudhë, qeveria ka me vendos a ka me ndërtua nen hekurudhë apo mbi, pra urë me bo, i ka qit 500 mijë euro ne buxhet në një projekt që kushton 17 milion euro, edhe e kemi paraparë nënkalimi tek qendra tregtare që u hap, a do të ketë nënkalime tjera varet prej projektit të rrugës.

Mehedin Salihu, neve ne letër po na dalin shumë të bukura këto mirëpo kur po dal prej këtu e po me pyet qytetari spo di me i tregu.

Hamit Kastrati, pyeti drejtoreshën Flutura Avdiu, sa është e parapame stacioni i autobusëve sa ka hapësirë,?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kur ka qenë kryesues Labinot Halilaj, e kemi shpall interes të përgjithshëm pronën e hekurudhës me marrë ne shfrytëzim komuna për interesa te veta, në atë pronë e kemi kërkuar interesin e përgjithshëm me arsyen për me e vendos edhe stacionin e autobusëve afër stacionit te trenit, Qeveria Kurti, ka thënë që po e bene rrugën Prishtinë-Drenas-Durrës dhe ka me pas qarkullim të shumtë, ka me qenë një stacion i cili ka me qenë shumë i rëndësishëm jo vetëm për qytetaret e Drenasit, nuk jemi duke e bërë Hamit sepse ende pronën nuk na kanë shit ose nuk na kanë kalu, është nal në proces sikurse që janë nal shumë procese tjera, që është Liqeni i Verbocit, rruga katër korsi etj etj, pra veni ka me qenë i mjaftueshëm janë standardet evropiane të komunikacionit që është e mjaftueshme për atë dedikim. Stacioni i autobusëve nuk është parking për autobusë.

Labinot Halilaj, në këtë rast mendoj se u dashtë me qenë më të kujdesshëm ne lidhje se çka po votojmë, plani rregullativ i qendrës se qytetit ka implikime, ne mundemi me pas një plan rregullativ sot por pas pesë viteve na derivon edhe këtë plan rregullativ me ndryshu.

Albulena Saliuku, falënderoj përfaqësuesit e kompanisë, meqenëse është vetëm një plan dhe kane punu edhe kompanitë tjera, besoj se i morën gjitha sqarimet që ishin sigurisht te nevojshme, dhe për shkak se i gjithë projekti që do te bëhet do të bazohet në këtë plan, do të behet plani dhe besoj se do të kemi mundësi ti marrim detajet tjerë ama te hollësishme.

Pas këtyre diskutimeve vërejtjeve, sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 22 anëtar, 7 vota kundër, 1 votë abstenim, u miratua **Propozim vendim për miratimin e planit rregullues të hollësishëm për qendrën e qytetit-Glllogoc.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt rendit të ditës: **4. Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.**

Meqë nuk pati diskutimeve vërejtje, sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua **Propozim vendim për financimin e projektit nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë rendit të ditës: **5. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutimeve vërejtje, sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua **Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-26071, dt.1.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë rendit të ditës: **6. Propozim vendim për miratimin e kërkesës, Nr.01-070/01-28069, dt.13.6.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes OU Nicrophthalma, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Meqë nuk pati diskutimeve vërejtje, sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë rendit të ditës: **7. Propozim Vendim për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Zveçanit.**

Egzona Tërdevci, parismisht si grup jemi “për” por a ka kapacitet administrata e komunës që me kry shërbime edhe për komunë tjera duke pas parasysh që nga një here nuk mbërrin me i kry as për qytetaret tanë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, duke i shiku nevojat e domosdoshme të Komunës së Zveçanit ne i kemi pyet zyrtaret certifikuar që janë a mujn me marrë edhe këtë përgjegjësi dhe janë deklaruar se mujn, ligji e lejon, jemi konsultuar edhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe ne ju kemi përgjigjur pozitivisht kërkesës së Komunës së Zveçanit për memorandum mirëkuptimi ku do t’i kryejnë disa shërbime derisa ata ti certifikojnë zyrtaret e vet për qëllime të cilat i kanë.

Meqë nuk pati diskutimeve vërejtje, sugjerimeve tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **“Për”** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua, **Propozim Vendimi për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Zveçanit.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne kemi me votu krejt si pikë të rendit të ditës por është veç ndryshimi 24 mijë euro, nuk e di saktë me shifra, kemi me e votu prej mallra dhe shërbime ne subvencione sepse qeveria ka kerku ashtu sepse i takojnë me e bërë bartjen e mjeteve që kanë qenë të parapamë për atë sektor për kulture rini dhe sport.

Meqë nuk pati diskutimeve vërejtje, sugjerimeve tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **“Për”** votuan 25 anëtar, 5 vota kundër, abstenim nuk pati, u miratua **Vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Të ndryshme.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, I nderuari kryesues i Kuvendit të Drenasit z.
Hajdari, asamblistë, qytetarë, zonja e
zotërinj,

E nderuara asambliste Tërdevci,

Ditën që kam munguar në Seancë, kam marrë pjesë në Mbledhjen e
Komisionit Ndërmnistror për Investime Strategjike, të ftuar nga niveli
qendror, për shqyrtimin e kërkesave të kompanive me interes strategjik.

Aty është trajtuar edhe kërkesa e kompanisë që ka shfaq interes për
investime në Drenas.

Me 975 fjalë po përgjigjem ndaj akuzave të pabaza, të thëna në mbledhjen
e kaluar të Asamblesë dhe kjo bëhet për qytetarët jo për juve, sepse, nga
ato që keni thënë, nuk meritoni përgjigje.

Egzonë, ta provoni guximin tim, vërtetë është guxim. Kur thua frika,
duhet ta dish, e kam thënë në disa raste, po e përsëris: Moti jam i operuar
prej frikës, që kur më ka bërë operacion daja i Vjosa Osmanit, Haxhi Bajrami i Vërbocit, kur
i kisha vetem gjashtë vjet.

Për këtë flasin veprat dhe jeta ime, andaj, fjalët tua nuk i marrë serioze.

Letrat e mia për çështjet e caktuara kanë qëllim informues, jo për t'ju
bindur, as për t'ua ndryshuar qëndrimin. Pra, mos i keqkuptoni dhe bëjeni
dallimin.

Asambleja është institucioni më kredibil i komunës tonë që qytetarët
mund ta krijojnë me votën e tyre, nëse këtë funksion nuk e dini ndjej
keqardhje për Juve.

Po kthehem te çështja thelbësore.

Sheshi "Fehmi Lladrovci" do të ndërtohet, është fat që Ai ishte bir i
Drenasit dhe kombit shqiptar.

Postimet që i keni cituar, kanë interpretime të pasakta.

E nderuara asambliste,

Granti i performancës është dedikuar për Sheshin që do ta bëj shenjë
identifikuese për këtë asamble. Asgjë nuk ka këtu personale.

Drenasi e meriton sheshin. Mos harroni, ne jemi komunë kampion, me
vite. Granti i performancës komunale vije nga këto suksese. Pasaktësitë
tjera janë të paarsyeshme të demantohen.

Mirë që nuk je juriste, por as asambliste e vëmendshme, sepse,
memorandumi është i qartë. Ju nuk jeni në dijeni për procedurat, as për

detyrimet ligjore për realizimin e projektit.

Mos harroni, padija nuk është argument.

Tash t'i kthehemi edhe një herë çështjeve të cilat zonja Egzonë, nuk i kupton.

Ligji i prokurimit publik dhe ligji mbi ndarjet buxhetore të cilat sanksionojnë hyrjen në obligime pa u siguruar/buxheti.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, thotë:

Neni 9: Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, citoj:

“Paragrafi 3. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.”, mbaron citati.

Kjo nënkupton që çdo inicim për aktivitet të prokurimit nuk duhet të tejkaloj shumën buxhetore të ndarë, përfshirë vitin aktual dhe dy vitet e ardhshme, të aprovuar me ligjin e buxhetit përkatësisht tabela 4.2, për financimin e projekteve kapitale.

LIGJI NR. 08/L-193 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2023,

Neni 12, “Limitet në zotime dhe shpenzime”, citoj:

“Paragrafi 9: Çdo Organizatë Buxhetore duhet të regjistrojë në PIP dhe SIMFK zotimet shumëvjeçare për projektet kapitale si dhe të vendos kontratat për projekte kapitale të lidhura me punë kryesit. Obligimet për projekte kapitale regjistrohen si ‘urdhër blerje’ në SIMFK në tri (3) vite, vetëm në përputhje me kontratat e lidhura për ato projekte kapitale, të planifikuara në tabelat buxhetore si dhe të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP)”, mbaron citati.

Nga kjo kërkesë ligjore del se: projektet shumëvjeçare përveçse duhet ta kenë buxhetin e ndarë për vitin aktual dhe vitet e ardhshme, kërkohet që edhe mjetet të zotohen edhe për vitet e ardhshme.

Struktura e financimit të projektit të Sheshit “Fehmi Lladrovci”:

MAPL 916,388.80 euro

Demos 1,118,387.08 euro

Komuna 2,457,884.72 euro

E vërtetë Egzonë, projekti nuk është 4.5 milion euro por 4.492.660 euro e 60 cent.

Pjesëmarrja e këtij projekti në shpenzimet kapitale në përqindje përfaqëson pjesëmarrjen 65%...pra, demantim i plotë për deklarin paushall, prapë keqardhje për ty Egzonë.

Ndërsa nga letra e MAPL, po citoj:

“Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e ka pranuar kërkesën nga komuna e juaj, e cila është trajtuar në bashkëpunim me projektin DEMOS. Në vijim gjeni përgjigjen:

Mjetet e MAPL, për financimin e projektit bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit dhe rregullat e financimit nga ligji i buxhetit vjetor, kërkojnë të realizohen brenda vitit fiskal, dhe nuk mund të barten në vitin tjetër. Shpenzimi apo mos shpenzimi i tyre nga ana e Komunës ndikon në performancën buxhetore të MAPL-së, pasi ato janë pjesë e buxhetit të MAPL-së.

Sa i përket Grantit të Performancës Komunale, kontributi i donatorëve bën pjesë në buxhetin total të komunës. Nëse komuna nuk i shpenzon 75% të buxhetit për investime kapitale (ku bën pjesë edhe kontributi i donatorëve), atëherë komuna diskualifikohet për grantin në vitin vijues (varësisht nga rregullat e grantit të aprovuara për atë vit)”, mbaron citati. Kaq sa për ligjshmërinë.

Zonja Tërdevci,

Ju nuk mund të më detyroni të mbrohem për gjërat që nuk i bëj, apo për gjërat që të tjerët i shpifin për mua, në veçanti frikacakët.

Andaj, kjo përgjigje le të shërbej për Juve e secilin që nuk i njeh ligjet e të informohet, para se të shtrembëroj realitetin. Ky informim i detajuar mund të bëhet çdo ditë te zyrtarët profesional të komunës tonë. Ne nuk mund të jemi kampion nëse nuk do të ishim edhe kampion të zbatimit të ligjit.

E di se kjo shumë kujt nuk i pëlqen as në Drenas as jashtë Drenasi, por ne ia kemi marrë dorën dhe vazhdojmë të jemi më të mirët. Edhe ju asamblistë të nderuar keni kontribut që ne jemi komuna me performancën më të mirë komunale në nivel nacional.

Ju falënderoj për bashkëpunim.

Ju falënderoj dhe uroj për bashkëpunim për çdo çështje që i takon interesit qytetar dhe zbatimit të ligjit. Të tjerat janë lehtë, opozitarizmi as ka filluar me Egzonën, as mbaron me Egzonën.

Faleminderit!

Egzona Tërdevci, nuk e pata njet me fol hiq se nuk vlen asnjëra prej atyre që e the, por për shkak që paske mundu shumë njerëz me ta shkru tan këtë letër me erdhi keq mos me tu përgjigj, opozitarizmi tim, dijeninë teme nuk e vlerësoni ju, nuk jeni ju mbikëqyrës i joni, ne jemi mbikëqyrësit tuaj për mos me harrru, secila fjale që e kam thënë seancën e kaluar vlen, i keni edhe citatet e ligjeve, konsultohuni me ata që jeni konsultua për këtë letër ndoshta ua shpengojnë më mirë, dhe sa i përket heroit Fehmi Lladrovci unë sikurse secili qytetar i Kosovës e sidomos i Drenasit ndihna krenar që e kemi pas një luftëtar të tillë një strateg të tillë por po më vjen keq çka ka lenë mbrapa.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këtë reagim të bëra për qytetaret jo për juve, kur t'i lexojsh ligjet Egzonë lexoj deri në fund mos i lexo vetëm pjesën ku te konvenon sepse pastaj është ligji si llastiku.

Egzona Tërdevci, dijeninë time nuk e vlerësoni ju, unë nuk e arsyetoj kryesuesin që vazhdimisht lejon qasje të tillë, para një muaji kur te vyke vota jone thojshë hajt se bre si motër pot luti atëherë nuk isha e padijshme, por tani ke kry punë, se i ke ble tjerët, ne nuk blihem as nuk shitemi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Egzonë edhe për blerje në gjykatë të qoj dhe për këtë punë e merr vesh atje kanë e kam ble e kanë se kam ble.

Azemine Gjoka, unë i kam tri shqetësime nga qytetaret e Komunës se Drenasit, e para është cila është arsyeja që nuk ka përfundu rruga Vasilevë tek "Kroni i Mbretit" pasi që e dimë që rruga është vetëm 300 m ndërsa po i jepni prioritet rrugëve tjera te cilat kane edhe alternativa tjera. Çështja e dytë rruga "Selman Demiçi" në qytetin e Drenasit qytetarët kane bërë një peticion nga banoret e kësaj lagje kane kërkuar që mos të ndërtohen ndërtesa të larta pa u zgjeru rruga që aktualisht është 3 m, ndërsa kërkohet që te behet afër 10m. Pyeti edhe Drejtoreshën e Shëndetësisë se cila është arsyeja pse nuk i keni pagu punëtorët të cilët kanë punu në ndërrimin e natës pas orarit të punës për orë shtesë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, rruga Vasilevë tek "Kroni i Mbretit dhe lagjet e fshatrave te tjera për rreth janë një projekt i vjetër i qeverisë, është shpall tenderi e ka marrë kompania ofertuesi dhe nuk i ka kry punët me arsyetimin se gjatë pandemisë janë rrit çmimet, unë e kam lidh një memorandum tjetër me zv. ministrin e Infrastrukturës ku ia kemi mundësua kompanive që kane punu edhe që iu kane mbet punët pa kry sa i përket fjalëve ne fjalë për shkak te ngritjes se çmimeve, kompania në fjalë ka deklarë që ka me e kry, por nëse nuk e kryen deri me 30 qershor i merret garancinë. Sa i përket rrugës "Selman Demiçi" askush nuk ka të drejtë peticioni me ia ndal punën askujt për me i qit kushte për prona të veta sepse është një hartë zonale, ka një plan zhvillimor të hollësishëm i cili e rregullon. Sa i përket arsyes se pse nuk janë pagu mjeket në QKMF është në hetim sepse mjeku që e ka zëvendësua mjekun nuk e ka shkru që e ka zëvendësua mjekun por e ka shkru që po kryen pune jashtë orarit të punës, ndërsa mjeku që ka mungu prapë edhe ai e ka marrë mëditjen sepse su regjistru, prandaj ne nuk paguajmë dy herë dhe janë duke u zhvillu këto procedura.

Mërgim Pirraku, pyeti drejtorinë z. Endrit Gllareva, drejtorja e infrastrukturës nuk ka realizua asnjë projekt as nuk ka fillua dhe as nuk ka vazhdua asnjë projekt për fshatin Sankoc a mundeni me dhënë përgjigje për qytetaret sepse ata vazhdimisht kanë pas disa kërkesa për vazhdimin e punimeve për kanalizim, për zgjerimin e disa rrugëve për trotuare e disa të tjera pse po ndodh brenda 6 muajve mos me ndodh asnjë punim dmth 0 kanë qenë punimet në atë fshat, cilat janë punimet që janë të planifikuara për gjashtë mujorin e dytë ose edhe për vitin e

ardhshëm. Kanë qenë disa fshatra që janë lënë anash ndoshta prej pas lufte dhe janë realizua shumë projekte, njeri prej tyre është fshati Sankoc dhe Fushticë e Lartë, kërkoj që nga kjo drejtori me u zhvillua ma shumë projekte sepse ata qytetar po ndihen të diskriminuar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju e dini që deri në prill-maj edhe për shkak të kushteve atmosferike edhe për shkak të buxhetit sepse buxheti u alokua me vonës dhe procedurat sigurisht që janë vonu, sepse nuk mundemi me qu diçka ne prokurim pa pas alokim, kontrata u nënshkrua për rrugën Sankoc dhe shumë shpejt kane me hy në zbatim, kështu që edhe punët që i kemi premtu kemi me i kry, kerkush nuk mundet me penalizua një komunitet nga i cili jam votu pse e ka pas një kandidat. Kjo ka pak rendësi qytetari është për neve i barabartë dhe jam i sigurt që punoj 100% për çdo lokalitet.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:55 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 29.06.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari